



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.17, datë 29.05.2023

P Ë R

MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:  
“GODINË BANIMI 1, 2, 3, 4 DHE 5 KATE I SHKALLËZUAR, ME 2 KATE NËNTOKË”,  
ME VENDNDODHJE NË BASHKINË DURRËS

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 7, pika 2, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Auxhesti & S” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Godinë banimi 1, 2, 3, 4 dhe 5 kat, me 2 kate nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Durrës, me subjekt zhvillues shoqërinë “Auxhesti & S” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë, bashkëlidhen si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË


BELINDA BALLUKU



SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 06 / 01 /2024